



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Data 02 .03.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparime e mirëmbajtje mjete transporti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash **(50112000-3)**

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,950,333 (gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë PA TVSH.

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik i ndryshuar”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kriteret e përgjithshme

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi:

Këto kërkesa vendosen në përputhje me nenet 76, 82 dhe 83 të Ligji nr. 162/2020 si dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Këto dokumente janë standarde, të detyrueshme dhe garantojnë seriozitetin e ofertës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore nga operatorët ekonomikë.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.1 Xhiro vjetore

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga këto vite duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa bazohet në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Përqindja e kërkuar është brenda kufijve të përcaktuar ligjorë dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për të verifikuar që operatori ekonomik disponon qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

3. Aftësitë teknike dhe profesionale

3.1 Përvoja e ngjashme

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Dokumentacioni provues:

a) Për kontrata me sektorin publik – vërtetime të lëshuara nga autoritetet përkatëse për realizimin me sukses të kontratës, ose fatura tatimore sipas legjislacionit në fuqi;

b) Për kontrata me sektorin privat – fatura tatimore të deklaruara pranë organeve tatimore.

Në rast të realizimit të kontratave si Bashkim Operatorësh Ekonomikë apo si Nënkontraktor, operatori duhet të paraqesë përkatësisht marrëveshjen e bashkëpunimit apo marrëveshjen e nënkontraktimit, si dhe dokumentacionin bazë për të provuar pjesën konkrete të realizuar prej tij.

Argumentimi:

Kërkesa vendoset në mbështetje të nenit 77 të Ligji nr. 162/2020 dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Vlera e kërkuar është proporcionale me objektin e kontratës dhe synon të garantojë që operatorët ekonomikë disponojnë përvojën e nevojshme teknike për realizimin e shërbimit.

3.2 Licenca profesionale

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Argumentimi:

Kërkesa bazohet në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020, nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si dhe në Ligji nr. 9573, datë 03.07.2006 dhe aktet nënligjore përkatëse.

Licenca është e detyrueshme për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi dhe garanton përmbushjen e standardeve profesionale të kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

3.3 Disponimi i ambientit të servisit

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi një ambient/servis të përshtatshëm për realizimin e shërbimeve objekt kontrate.

Disponimi vërtetohet me dokumentacion që provon pronësinë, huapërdorjen ose qiramarrjen sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Në rast se servisi ndodhet jashtë Qarkut Korçë, operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se merr përsipër transportin e mjeteve me shpenzimet e veta.

Argumentimi:

Kërkesa mbështetet në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar realizimin e shërbimit në kushte teknike të përshtatshme dhe nuk përbën kufizim territorial, pasi lejon pjesëmarrjen e operatorëve nga çdo zonë, duke garantuar transportin me shpenzimet e tyre.

3.4 Pajisjet teknike

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se ambienti i servisit është i pajisur me pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, përfshirë:

- Pajisje diagnostikimi kompjuterik (program universal);
- Repart xhenerik;
- Repart motorik;
- Repart elektroaut;
- Ura ngritëse;
- Pajisje për kontrollin e sistemit të frenimit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për inspektim në vend për verifikimin e deklarimeve.

Argumentimi:

Kërkesa vendoset në përputhje me nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Pajisjet e kërkuara janë minimale dhe të domosdoshme për realizimin profesional të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve.

3.4.1 Personeli teknik

Operatori ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë minimalisht 3 (tre) punonjës teknikë, si më poshtë:

- a) 1 (një) Inxhinier Mekanik ose Mekatronik;
- b) 1 (një) Mekanik;
- c) 1 (një) Elektroaut.

Dokumentacioni provues

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet:

- Të vetëdeklarojnë disponimin e personelit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 10).

Ndërsa ofertuesi i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë:

Për Inxhinierin Mekanik/Mekatronik:

- Diplomë e arsimit të lartë përkatës;
- Kontratë pune e vlefshme, me kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Për Mekanikun dhe Elektroautin:

Për mekanikun dhe elektroautin kërkohet kontratë pune e vlefshme ku të specifikohet pozicioni përkatës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin diplomë të arsimit profesional/certifikatë kualifikimi profesional ose çdo dokument tjetër që provon formimin teknik ose përvojën në profesion.

Për të gjithë personelin:

- Listëpagesat për 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Dokumentet duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi

Kriteri është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligji nr. 162/2020 dhe nenit 41, pika 4, shkronjat b) dhe c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të garantohet që operatori ekonomik disponon personelin teknik të kualifikuar dhe të mjaftueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal i punonjësve është përcaktuar mbi bazën e:

- *Natyrën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit mekanik, motorik dhe elektroauto;*
- *Numrin dhe tipologjinë e automjeteve objekt shërbimi;*
- *Nevojën për realizimin paralel të shërbimeve brenda afateve të kontratës;*
- *Organizimin teknik të proceseve të punës në një servis të specializuar.*

Kërkesa është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe nuk përbën kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi përcakton një minimum të domosdoshëm teknik për realizimin e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit,sasite,termat e references dhe specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr.13 Prot.,date 02.02.2026.

Specifikimet teknike të shërbimeve objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për këtë shërbim. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punes bëhen pjesë e dokumentave te tenderit.

GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjete) muaj nga data e lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.

Vendi i shërbimit: Në servisën e OE.

NJËSIA E PROKURIMIT

Pëllumbesha Nurçe	Kryetare
Klea Qylafi	Anëtare
Liljana Myrtollari	Anëtare